

ALVA DANI

FISHTA DHE HIMNET E SHENJTA TË MANZONI-T

Abstrakt

Përkthimet e Gjergj Fishtës janë një kontribut me shumë vlerë për kohën kur u sollën dhe një argument me shumë interes që sot meriton të zgjerohet dhe të analizohet. Alessandro Manzoni (1785-1873), romancieri dhe poeti romantik italian ishte njëri nga shkrimtarët e mëdhenj, që Fishta studioi dhe përktheu që në moshë të re. Nuk ishte e rastësishme përzgjedhja dhe pasioni rinor për të përkthyer Manzoni-n, poetikën dhe psikologjinë e tij. Te ky klasik italian, përfaqësues i denjë i romanticizmit, poeti ynë kombëtar gjeti një shkrimtar me një besim të fortë fetar, me një filozofi poetike që do të linte gjurmë dhe do ta frymëzonte jo rrallë herë, gjatë krijimtarisë së tij poetike. Përkthimi i *Himneve të shenjta* tregon se Fishta u përket atyre përkthyesve që u qëndrojnë besnikë përmbajtjes dhe stilit të autorit, duke ruajtur pa asnjë kompromis shpirtin e poezisë dhe të poetit. Edhe pse i ri në moshë, tek Fishta tashmë spikaste pasioni i një poeti të madh, ndjeshmëria e thellë për të kapur edhe nuancat më të imëta kuptimore, që shpesh herë burojnë edhe nga teknikat stilistikore apo kombinimet tingullore mes fjalëve a mes vargjeve.

Fjalë kyçe: *përkthim, himn, poezi, fetar, i shenjtë, teknikë stilistikore*

Përkthimet e Gjergj Fishtës janë një kontribut me mjaft vlerë për kohën kur u sollën dhe një argument me shumë interes që sot meriton të zgjerohet dhe të analizohet, ashtu siç bëhet me tërësinë e veprës së këtij autori mjaft të rëndësishëm të letërsisë shqipe. Përkthimi është një veprimtari tunduese për çdo shkrimtar e filolog, një veprimtari për të cilën kanë nevojë të gjitha kohërat dhe të gjitha kombet.

Shqipëria e pas 1900-ës, kishte nevojë të ethshme për përkthime, për letërsi dhe për shkrimtarë të mirë, megjithëse nuk kishte asnjë shkollë të mirëfilltë përkthimi. Por duhet thënë se kishte disa përkthyes me ndërgjegje të lartë intelektuale që i dhanë vlerë dhe profesionalizëm përkthimit duke u bërë pikënisja dhe pika referimi e përkthimeve në gjuhën shqipe. Puna e një

përkthyesi, do të shprehej në një intervistë përkthyesi i njohur Shpëtim Çuçka¹, duhet vlerësuar jo aq me kutin e kohës, kur ai ka punuar, por me qëndrueshmërinë e parimeve përkthimore që ai ka ndjekur dhe të vlerave që ka arritur.

Një nga këta emra, që ditën të vlerësojnë rëndësinë e përkthimit dhe domosdoshmërinë e tij ishte dhe Atë Gjergj Fishta O.F.M.. Ai mendonte se pasuria e madhe shpirtërore e kombeve duhej përkthyer dhe duhej studiuar në shkollë në mënyrë që të përpunohej shija estetike, të zhdërvjelltësohej gjuha, si nga fjalët ashtu edhe nga periudhat e shkrimit dhe të ligjërimit. Në një prej shkrimeve të tij rreth përkthimeve të Koliqit nga poetët e mëdhenj italianë, Fishta do të shkruante: “Veç na, komi shqyptar, si nder të gjitha sendet kshtû edhë nen ket pikpame kemi mbetë mbrapa gjithkujë – e jo gjithmonë për faj të huej – ke as klasikë t’onë s’kemi, as të huejt perkthye s’i kemi shqyp. Kshtû qi një zansë i joni, edhë mbasi të ketë mbaru sprovimet e maturitetit... nuk është i zoti në një rreth intelektualsh me hî në bisedë mbi klasikë e letrarë të komevet të hueja; ke nuk i ka ra kurr me lexue ndonji asî auktorësh të përkthyer shqyp”². Pra, përkthimi shihej nga Fishta si një domosdoshmëri për kohën, një shërbim i madh kombëtar që lidhej sidomos me edukimin e brezave.

Me shkrimtarët klasikë italianë ati françeskan u njoh fillimisht gjatë studimeve në Bosnje, ku mori formim ekleziastik dhe letrar. Alessandro Manzoni (1785-1873), romancieri dhe poeti romantik italian ishte njëri nga shkrimtarët e mëdhenj, që Fishta studioi dhe përktheu që në moshë të re. Nuk ishte e rastësishme përzgjedhja dhe pasioni rinor për të përkthyer Manzoni-n, më saktë, poetikën dhe psikologjinë e tij. Te ky klasik italian, përfaqësues i denjë i romanticizmit, poeti ynë kombëtar gjeti një shkrimtar me një besim të fortë fetar, me një filozofi poetike që do të linte gjurmë dhe do ta frymëzonte jo rrallëherë, gjatë krijimtarisë së tij poetike. Studiuesja Blerina Suta në një shkrim me titull “Manzoni dhe poetika e Fishtës” do të shkruante: “Duke analizuar gjuhën e përkthimeve të *Inni sacri*, mund të themi se lënda e Manzoni-t do t’i përcillet edhe asaj pjese të poezisë lirike të Fishtës që i jep vlerë religjionit si moral dhe si poezi: *Këshndellat; Të psuemit; Të ngjallunt; Rrëshajët* kanë lënë gjurmët e tyre në krijimtarinë lirike të Fishtës me frymëzimin e ri, të krishterë, që rrezatojnë”³.

Përkthimet nga Manzoni do të përmbliidhen fillimisht në veprën “Vjerrsha t’pershpirteshme t’kthyer shqyp” (Shkodër, Shtypshkronja e së Paperlyemes,

¹http://www.toena.com.al/toena/revista_Universi_Shqiptar_i_Librit/intervista/Me_perkthyesin_Shpetim_Cucka.html

² Gjergj Fishta, “Parathâne”, në Ernest Koliqi, *Poetët e mëdhej t’Italis*, Shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1932, f. X-XI.

³ Blerina Suta, “Manzoni dhe poetika e Fishtës”, *Exlibris*, nr. 153, Viti i IV i botimit, 23 tetor 2021.

1905) e pastaj përsëri te “Vallja e Parrizit” (Shkodër, Shtypshkronja “A.Gj.Fishta”, 1941)⁴.

Himnet e shenjta (*Gli Inni sacri*) të përzgjedhura nga Fishta janë fryt i një periudhe që përkon me konvertimin fetar dhe ringjalljen shpirtërore të Manzoni-t.

Kjo do të përbënte edhe një nga elementet më të rëndësishme të poetikës së shkrimtarit italian, do ta çonte atë drejt një mënyre të re të reflektuari dhe të kuptuarit të koncepteve dhe fenomeneve. Vizioni i tij për botën tashmë zotëronte një element të ri: Zotin. Kështu do të ndryshonte edhe koncepti i tij për letërsinë, për mënyrën e tij të shkruarit dhe *Himnet e shenjta* do të ishin pasqyrë e qartë e angazhimit të tij thellësisht të krishterë dhe sidomos të një poezie thelbësisht të reformuar. Nga këtu vjen edhe kreu i natyrshëm përkthimi i atit françeskan, duke u nisur jo vetëm nga frymëzimi fetar, por edhe nga fryma filozofike që mbart poezia manzoniane. Synimi i shkrimtarit ishte të krijonte dymbëdhjetë himne, të cilat do të përkujtonin festat më të mëdha të kalendarit liturgjik, por krijoi vetëm pesë: Të Ngjallunt (*La Risurrezione*), Emni i Zojes (*Il nome di Maria*), Këshndellat (*Il Natale*), Të Psuemit (*La Passione*) e Rrshajët (*La Pentecoste*).

Poezia “*Il Natale*” e përkthyer në variantin gegë *Këshnellat*, renditet e para në botimin përfundimtar të himneve (megjithëse po t’i referohemi kohës së krijimit (1813), figuron e treta). Vargjet e para të kësaj poezie karakterizohen nga një fjali shumë e gjatë që shtrihet në tri strofa shtatërokëshe në variantin origjinal, ndërsa në përkthim kjo fjali shtrihet në dy strofa shtatërokëshe. Strofa e parë mbart vlerën më të madhe të asaj figure letrare që shtrihet deri në dy strofat e tjera dhe që përkon me similitudën.

Si curr, qi nalt prej kulmit
T’nji rrpis s’termales s’grisme,
Shkepun andej mbas hovit
T’njaj rreshmje shâmë me krisme,
Turr neper drum t’thepisun
Teposhtë tu’ u rrokullisun,
Plandoset e n’fund e jet;

Qual masso che dal vertice
di lunga erta montana,
abbandonato all’impeto
di rumorosa frana,
per lo scheggiato calle
precipitando a valle,
batte sul fondo e sta;

Kjo figurë letrare rikrijohet mjeshtërisht nga Fishta, me një kapacitet të lartë stilistikor dhe saktësi konceptuale. Përkthimi synon të ruajë jo vetëm në nivel semantik, por edhe në nivel fonetik, atë imazh manzonian që krijohet nga rrokullisja e shkëmbit dhe nga palëvizshmëria e tij, pra, nga pozicioni statik në momentin që shkëmbi ndalon, duke përcjellë përmes këtij imazhi rrokullisjen e

⁴ A.Benedikt Dema O.F.M, *Veprimi letrar i A.Gjergj Fishtës O.F.M*, Shtypshkroja “A.Gjergj Fishta”, Shkodër, 1943.

njeriut, pas rëndesës së madhe që i shkakton pesha e fajit. Fjala që mbyll vargun shtatërokësh është një folje me theks të fortë fundor, e cila përcillet edhe në variantin shqip duke shkaktuar të njëjtin efekt stilistikor dhe kuptimor. Duhet thënë se bie në sy loja me efektet e tingujve, kryesisht me tingujt e vrazhdë dhe të errët, të cilat së bashku me aliteracionin në tingullin *r*, arrijnë të krijojnë zhurmën e ashpër të rrëshqitjes së dheut (vertice, erta, rumorosa frana). Vërejmë që edhe në variantin shqip Fishta ruan dhe përshtat me shumë mjeshtëri të njëjtin kombinim tingujsh, duke shkaktuar po të njëjtin efekt të zhurmës së rrokullisjes së shkëmbit që shkëputet nga lart. Në gjuhën shqipe aliteracioni krijohet me shumë kujdes përmes përsëritjes së shkronjës *rr* dhe *r* në po ato vargje dhe konkretisht tek fjalët: *curr*, *rrpis s'termale grisme*, *rreshmje*, *krisme*, *turr*, *rrokullisun*, duke krijuar kështu edhe një ritëm të brendshëm.

Strofa e katërt ruan në gjuhën shqipe me shumë besnikëri një sërë pyetjesh retorike, që mbartin për këtë poezi një ngarkesë të madhe kuptimore dhe emocionale, duke ruajtur të njëjtën forcë shprehëse edhe në gjuhën shqipe:

Kush nder sa janë t'lem mnijet
 Kush ishte njai *bir robit*,
 Qi t'Naltit Shejt t'paqasun
 Mund t'thote: *pshtona kobit*?
Besë t're me lidhë t'amshueme?
 Me nxierrë njatë pre t'pushtueme
 Qi ferri e mbate n'thonj?

Qual mai tra i nati all'odio,
 quale era mai *persona*
 che al Santo inaccessibile
 potesse dir: *perdona*?
 far novo *patto* eterno?
 al vincitore inferno
 la preda sua strappar?

Duke u nisur jo vetëm nga këto vargje, por edhe nga tërësia e këtij krijimi ne perceptojmë një pasuri të madhe imazhesh, ndjeshmëri dhe gjendjesh emocionale të cilat në thelb i referohen mundësisë për t'iu drejtuar Zotit dhe për të kërkuar faljen e tij, një domosdoshmëri që tejkalon edhe ligjet e natyrës. Gjuha e përdorur, dialekti gegë, do t'i lejonte përkthyesit përdorimin, jo vetëm të disa formave të caktuara leksikore, por edhe përdorimin e disa fjalëve kyçe të cilat shpjegohen vetëm përmes kodit zakonor të veriut. Fjala *besë*, e zgjedhur për të përkthyer fjalën *patto*, është një gjetje mjaft inteligjente e përkthyesit. Fjala *patto*, në ligjërimin biblik, do të thotë *një aleancë e re*, e krijuar me ardhjen e Krishtëritimit, mes Zotit dhe të gjithë njerëzve, me anë të sakrificës së birit të Zotit. Në përkthimin shqip, Fishta zgjedh pikërisht një fjalë, që mbart një ngarkesë të jashtëzakonshme kuptimore, shpjegimi i së cilës kërkon t'i referohemi një traditë të vyer zakonore të trashëguar me shekuj nga paraardhësit. Asnjë fjalë tjetër më mirë se *besa* nuk mund të shprehte një marrëdhënie hyjnore, deri në sakrifikim, siç është ajo e njerëzve dhe Zotit. Leksikun e Zotit dhe të popullit, Fishta e ndjen thellësisht dhe e njeh mjeshtërisht, dhe kjo është ajo që e dallon atë “ndër sa janë shkrimtarët e

letrave tona, porsi Shërbëtuer besnik të Fesë dhe puntuer të flakët t'Atdheut. Asht e kotë: as Fishtës s'mund t'i mohohet zhguni, as Shqipënisë Fishta"⁵.

Fishta kujdeset që çdo fjalë të marrë një kuptim sa më të plotë e të qartë në gjuhën shqipe, prandaj jo rrallë vjen i natyrshëm përkthimi i përmbajtjes së fjalëve dhe shpjegimi i tyre, më shumë sesa gjetja e një fjale tjetër ekuivalente në gjuhën e mbërritjes. Kështu kemi *bir rob* për *persona*, *pshtona kobit* për *perdona*, apo *t'njaj rreshmje shâmë me krisme* për *rumorosa frana*, *anmiqt* për *le avverse forze*, apo edhe këto dy vargje ku vërehet qartë një përkthim i përmbajtjes dhe i idesë që duan të përçojnë fjalët e poezisë në gjuhën italiane, duke anashkaluar një përkthim fjalë për fjalë e duke kaluar madje edhe në një inversion të rendit të këtyre vargjeve:

Me nxierre njatë pre t'pushtueme
Qi ferri e mbate n'thonj?

al vincitore inferno
la preda sua strappar?

Po në këtë poezi përkthyesi nuk lë pa vëmendjen e duhur edhe aspektin stilistikor të vargjeve, si një element që lidhet me stilin e shkrimtarit, me mënyrën e tij të shkruarit. Fishta evidenton me shumë kujdes disa nga figurat retorike, duke i sjellë të pacenuara si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Ruan figurën e anaforës në strofën e katërt, mes vargut të parë dhe të dytë:

Qual mai tra i nati all'odio
quale era mai persona

Kush nder sa janë t'lem mnijet,
Kush ishte njaj bir robit,

Ose edhe në rastin kur nuk e arrin formën e plotë të anaforës (në variantin italisht anafora gjendet mes vargut të katër dhe të pestë, Tu...Tu), në gjuhën shqipe realizon me po ato elemente figurën e përsëritjes, apo të anadiplozës, pa cenuar asnjë nga ngjyrimet kuptimore të origjinalit, duke e përcjellë me po aq natyralitet edhe në variantin e përkthyer. Për këtë i referohemi strofës së shtatë ku shohim se edhe në variantin shqip ruhen të njëjtat forma **Ti** dhe **ty**, që përsëriten në të gjitha vargjet, edhe pse jo në të njëjtat pozicione:

O Figlio, o **Tu** cui genera
L'Eterno, eterno seco;
qual **ti** può dir de' secoli:
Tu cominciasti meco?
Tu sei: del vasto epiro

O Bir, o **Ti**, qi i Amshuemi
T'lindë t'amëshuem si vetë
Kush ty mund t'thotë i kohvet:
Me mue ke dalë **Ti** n'jetë?
Ti je: 'i terthore qiellat

Kemi përsëri ruajtjen e apostrofit, që vjen në vargun e parë të po kësaj strofe, dhe përcillet i njëjtë edhe në gjuhën shqipe, pra **O Figlio** dhe **O Bir**, në

⁵ Gjin Duka, "Proza fishtjane", në *Shëzjat*, viti V, Nr.11-12, A. Urbinati, Roma, f. 454.

fillim të vargut. Po ashtu vjen me të njëjtën forcë antiteza e bukur e strofës së gjashtë, e krijuar mes dy vargjeve në kontrast me njëri-tjetrin, mes ferrave e shkurreve që kanë mbuluar gjithçka nga njëra anë dhe luleve e ngjyrave që po shpërthejnë hareshëm, në po të njëjtin vend, duke ruajtur të njëjtin imazh dhe të njëjtën atmosferë manzoniane:

dove copriano i bronchi
ivi germoglia il fior

Kû para mblote cunga
Tash lulja atje shperthen

Në parathënien e përkthimeve të Ernest Koliqit “Poetët e mëdhej t’Italis”, Gjergj Fishta do të shkruante mes të tjerash: “... fjala qi është zani i gjûhes, e mjetet neper të cillat trajtohet elokucjoni poetik e klasik e perbâhet, si me thânë, geni i ç’do gjûhe, edhë në perkthim të veprave klasike mund të ndërrojnë, në mënyrë qi gjithmonë të mos i përgjigjet fjala fjalës, masa me masë të vjerrshës, frazeologia, frazeologis etr., pse kta i perkasin genit ose natyrës së gjuhës në të cillen perkthehet, ... ndersa idea, stili e fisnikija e gjallnija e të shprehunit, tue kenë se burrojnë prej vetë shpirtit t’auktorit, ato duen ruejtë, dër kû mund të bâhet, të pa cenueme e ashtû si gjinden n’origjinal”⁶.

Pra, Fishta u përket atyre përkthyesve që u qëndrojnë besnikë përmbajtjes dhe stilit të autorit, duke ruajtur pa asnjë kompromis shpirtin e poezisë dhe të poetit. Disa elemente të stilit manzonian vijnë shumë natyrshëm përmes penës së Fishtës. Edhe pse i ri në moshë, tek Fishta tashmë spikaste pasioni i një poeti të madh, ndjeshmëria e thellë për të kapur edhe nuancat më të imëta kuptimore, që shpesh herë burojnë edhe nga teknikat stilistikore apo kombinimet tingullore mes fjalëve a mes vargjeve.

Në himnin tjetër të Manzoni, me titull *Të Ngjallunt* (Resurrezione), do të shohim një ringjallje të besimit në shpirtin e poetit, një thirrje të fortë gëzimi për mrekullinë sublime që tashmë e ka pushtuar. Ringjallja është fjala kryesore e liturgjisë së Pashkës, prandaj edhe ky himn mban një tonalitet të fortë liturgjik. Ati françeskan dhe poeti bëhen bashkë, duke sjellë një përkthim mjaft të përpunuar në gjuhën shqipe, si në nivel poetik ashtu edhe në atë teologjik. Gjenialiteti i Fishtës besonte në Fë dhe në Atdhë. Gjithë vepra poetike dhe shoqërore e Atë Gjergj Fishtës, do të shkruante Lasgush Poradeci “U pat zhvilluar rreth postulatit fetar dhe kombëtar. Me të vërtet, kû ka ide dhe ndjenjë më të madhe, më të denjëshme për t’a derdhur dhe kënduar në art, se sa ideja e Zotit, ideja e Atdheut! Këto tema Fishta i përlavduroj si artist dhe si njeri dyte realizuar të dy atributet e përjetshme, luftonjësínë dhe mendonjësínë, të besimit fetar ku ish kushtuar, të cilin ay e rrethonte përhera me fytyrën mistikërisht të

⁶ Gjergj Fishta, “Parathâne”, Ernest Koliqi, *Poetët e mëdhej t’Italis*, Nikaj, Tiranë, 1932, f. XIII.

adhuruar të Atdheut; ⁷. Prandaj këto himne vijnë jo vetëm nga pasioni për një poet të madh si Manzoni, por edhe nga besimi i fortë fetar që buron prej tyre.

Te kjo poezi vërejmë se përkthyesi ruan të njëjtin metër, strofën me shtatë tetërrokësha, duke qenë se ky himn në krahasim me të tjerët është më i hareshëm dhe kërkon një ritëm më të rregullt dhe më të rrjedhshëm, në mënyrë që të përshtatet dhe të jetë në harmoni të plotë edhe me përmbajtjen e poezisë. Kjo poezi karakterizohet nga një nevojë e ethshme komunikimi me të tjerët, nga një ndjenjë e brendshme e fortë, që të shtyn drejt një shpërthimi emocional, që gjen shprehje që në vargjet e para të poezisë. Segmentimi i vargjeve përmes shenjave të pikësimit përçohet në të njëjtën mënyrë edhe në gjuhën shqipe, të cilën poeti ynë i madh e njuh mrekullisht dhe di ta përdorë në të gjitha trajtat e në të gjithë regjistrat.

È risorto: or come a morte
La sua preda fu ritolta?
Come ha vinto l'atre porte,
come è salvo un'altra volta

...

È risorto: il capo santo
più non posa nel sudario:
è risorto: dall'un canto
dell'avello solitario

U ngjallë s'deknit: or' prej dore
Preja mordes si i ka pshtue?
Si i ka mujtun dyerët mizore,
Si ka pshtue Njai, qi pushtue

...

U ngjallë s'deknit: ftyra e gzueshme
nën pëlhurë nuk rrin mâ ngrit;
U ngjallë s'deknit: e randueshme
m'njanë ânë t'vorrit kaperdit

Thirrja manzoniane, për besimin e ringjallur, vjen po aq emocionale dhe po aq tronditëse edhe në variantin shqip. Ruhen me përpikëri shenjat e pikësimit, duke marrë gjithë ngarkesën që kanë në poezi, si pjesë e rëndësishme përmbajtësore. Tonaliteti liturgjik, si pjesë thelbësore e këtij himni, i shton entuziazmit të madh të ringjalljes edhe solemnitetin e duhur të lutjes katolike. Si rrjedhojë fjala kyçe **è risorto**, shqipërohet në variantin **u ngjallë s'deknit**, duke dhënë të qartë përmbajtjen e fjalës dhe mesazhin liturgjik që ndërthen. Ky variant do të shpjegonte më mirë, për lexuesin shqiptar, fenomenin fetar që përfaqëson ringjalljen e Krishtit nga vdekja, duke e përcjellë me të njëjtën habi që shkakton një zbulim i rrallë.

U ngjallë s'deknit vjen si një lajmërim që përsëritet tri herë në fillim të vargjeve, përmes teknikës së anaforës, e cila mjeshtërisht ruhet edhe në gjuhën shqipe. Po në këto vargje bie në sy anafora tjetër mes vargut të tretë dhe të

⁷ Lasgush Poradeci, *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, në *Gjergj Fishta*, nën kujdesin e revistës "Shkëndija", Shtëpia Botonjese Luarasi, Tiranë, 1941, f. 22.

katërt të strofës së mësipërme, me përsëritjen në fillim të vargjeve të fjalës **si... si** (come...come). Apo edhe anafora e strofës së fundit, mes vargut të pestë dhe të gjashtë, mes **por... por**, (ma... ma):

ma pacata in suo contegno
ma celeste, come segno
della gioia che verrà.

Por i paqët e mbrenda vendit,
Por qielluer, si shêj gazmendit,
Qi nder valle t'qiellës ushton.

Duke iu referuar aspektit leksikor, përkthyesi ndjek të njëjtën teori të besnikërisë ndaj mesazhit të autorit dhe përmbajtjes së vargut, ashtu si edhe me poezinë e mësipërme Il Natale. **Il capo santo** përkthehet **ftyra e gzueshme**, duke evituar përkthimin *ad litteram*, sepse në kontekstin e poezisë nuk do të arrinte të përcillte gjithë entuziazmin e brendshëm dhe të jashtëm për fenomenin që po ndodhte. Prandaj duhej reflektuar dhe përçuar me fjalë të qarta dhe konkrete që **il capo santo** ishte **ftyra e gzueshme e Krishtit që u ngjallë s'deknit**, duke nxjerrë në pah fitoren hyjnore mbi vdekjen.

Po ashtu edhe në vargun *ma celeste, come segno / della gioia che verrà*, verifikojmë të njëjtën metodë përkthimi në nivel përmbajtësor, duke e sjellë në formën *por qielluer, si shêj gazmendit / qi nder valle t'qiellës ushton*. Shohim që për përkthyesin shqipërimi duhet të jetë sa më i kuptueshëm për nivelin e lexuesit shqiptar të kohës. Duhet të marrim në konsideratë edhe faktin që përkthimi është bërë nga Fishta në vitin 1906, periudhë në të cilën populli shqiptar ishte në një errësirë totale të dijës dhe të kulturës. “Popullsia shqiptare ishte në përqindje të lartë analfabete, rreth 90%. Orientimi kulturor ishte kryesisht lindor dhe kryeveprat botërore, qofshin të Lindjes apo Perëndimit, kishin pak shumë gjasa për t’u përçafuar nga një masë e gjerë lexuesish... Kultura perëndimore e ajo italiane në veçanti kalonin më parë nga Veriu shqiptar, nga kultura shkodrane, duke gjetur shtrirje jo fort të gjerë gjeografike në Shqipëri”⁸. Pra, shqiptarët e njihnin shumë pak Manzoni-n, atë e lexonin vetëm ata që kishin familjaritet me kulturën italiane dhe ky lexues padyshim fliste dhe shkruante në gegërisht, ashtu si edhe shumë klasikë të tjerë italianë të përkthyer më vonë nga Ernest Koliqi.

Për t’u kthyer përsëri tek përkthimi i vargut manzonian, tërheq vëmendjen një similitudë, që përsëri shtrihet përgjatë dy strofave, tre dhe katër, pas së cilës vjen thirrja e lumtur e Alessandro-s, që synon të bëjë për vete dhe të bindë një publik më të gjerë, duke zgjuar mendjet e mjegullta dhe shpirtrat e trazuar. Edhe në përkthimin shqip secila strofë mban njërin nga pjesët e similitudës, duke ruajtur edhe metrin shtatërrokësh manzonian. Përkthimet vijnë edhe me

⁸ A. Hafizi, “Përkthimi në gegërisht i romanit të Manzoni”, në *Identitete gjuhësore dhe kulturore, Studime shqiptare 15*, Shkodër, 2010, f. 49-48.

disa shpjegime të nevojshme në gjuhën shqipe që u referohen shprehjeve dhe apo fjalëve të caktuara dialektore, si për shembull:

plima-plima – tuba-tuba
 curr – shkam, shkrep
 jeten preku – zgjohet
 dyndi – çoi perpjjetw, largoi
 tu' i rrekun- tue i mundue
 t'kobitshem – të mjerë
 s'irnueme – së nxime
 në ravë t'shemtueme – në rrugë të mjerë të gabimit.
 ruba – peca; në kuptim të njimendte rubë thirret faculeta.

Po ashtu, në fund të faqes gjejmë jo vetëm shpjegime që lidhen me kuptimet e fjalëve dialektore, por edhe disa sqarime dhe të dhëna që plotësojnë njohuritë e lexuesit në lidhje me shumë personazhe apo fenomene fetare që shfaqen në vargjet e himneve. Të tilla si:

Zemer-ngrimes - Maris Magdalenë; Vashës s'pabesë – Dalilës, qi trathtoi Sampsonin, e shembullon Sinagogen qi salvoi Krishtin; T'mikut qi besës i bân lak – e Judës Apostull, qi trathtoi Krishtin; Porsi i forti etj... - Et excitatus est tamquam dormiens Dominus, tamquam potens crapulatus a vino. Psalm., LXXVII, 65.

Në përfundim mund të themi se përkthimet e himneve të Manzoni nga gjuha italiane duhen parë si një vlerë e shtuar në tërësinë e përkthimeve të klasikëve italianë dhe si një dimension tjetër i figurës poliedrike të poetit tonë kombëtar Gjergj Fishta. Mjeshtëria e gjuhëtarit dhe e poetit bëjnë që këto përkthime të lexohen me endje edhe sot, jo vetëm për të njohur poezinë e shkrimtarit klasik italian, por edhe për të pasuruar leksikun e sotëm me fjalët dhe shprehjet e rralla të popullit, të cilat ati françeskan i kërkoi me ngulmimin e një studiuesi të thekur dhe me pasionin e një atdhetari të flaktë.

BIBLIOGRAFI

- Dema, A. Benedikt (O.F.M), *Veprimi letrar i A.Gjergj Fishtës O.F.M*, Shtypshkroja “A.Gjergj Fishta”, Shkodër, 1943.
- Duka, Gj., “Proza fishtjane”, *Shëjzat*, viti V, Nr.11-12, A. Urbinati, Roma.
- Ferroni, G., *Storia e testi della letteratura italiana. Restaurazione e Risorgimento (1815-1861)*, Mondadori Università, Milano, 2003.
- Fishta, Gj., *Parathenie, Poetët e mëdhej t'Italis*, vëllimi i parë, Shtypshkroja “Nikaj”, Tiranë, 1932.
- Fishta, Gj., *Vepra letrare 10*, Enti Botues Poligrafik, 2004.
- Fishta, Gj., *Vierrsha t'pershpirteshme t'kthym shcyp*, 1905.

- Hafizi, A., “Përkthimi në gegërisht i romanit të Manzoni”, në: *Identitete gjuhësore dhe kulturore*, Studime shqiptare 15, Shkodër, 2010.
- Koliqi, E., *Dante e ne shqiptarët*, në Vepra 5, Konica, Prishtinë, 2003.
- Paci, E., “Veprat lirike të Atë Gjergj Fishtës O.M.F. në një përvjetor të ndarjes së tij nga jeta”, në At Gjergj Fishta, *Lirika*, Botime Françeskane, Shkodër, 2020.
- Pazzaglia, M., *Gli autori della letteratura italiana, terzo volume*, Zanichelli editore, Bologna, 1970.
- Poradeci, L., *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, në: *Gjergj Fishta, nën kujdesin e revistës „Shkëndija“*, Shtëpia Botonjëse Luarasi, Tiranë, 1941.
- Suta, B., “Manzoni dhe poetika e Fishtës”, *Exlibris*, nr. 153, Viti i IV i botimit, 23 tetor 2021.

SUMMARY

FISHTA AND SACRED HYMNS BY MANZONI

Gjergj Fishta's translations are a priceless contribution for the time when they were produced and an argument of great interest that deserves to be expanded and analyzed these days. Alessandro Manzoni, an Italian romantic novelist and poet, was one of the greatest writers that Fishta studied and translated at a young age. The selection and youthful passion to translate Manzoni, his poetics and psychology, as well, was not fortuitous. Inside this Italian classic writer, our national poet found a worthy representative of romanticism, a writer with a strong religious faith and a poetic philosophy that would leave a sign and would inspire him not infrequently during his poetic creativity. The translation of the *Inni sacri (Sacred hymns)* shows that Fishta belongs to those translators who remain faithful to the content and style of the author preserving without any compromise the soul of the poem and the poet. Even though at a young age, Fishta already had the passion of a great poet, the deep sensitivity to capture even the smallest shades of meaning, which often derive from stylistic techniques or sound combinations between words or verses.